



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:202384

Datë: 03.06.2024

Numri i dokumentit: 05768827

PAKR.nr.689/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Krime të Rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Xhevdet Abazi, kryetar i kolegjit, Hashim Çollaku dhe Kadrije Goga-Lubishtani, anëtar, me bashkëpunëtorin profesional Endrit Ajeti, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarve A.F., nga fshati, Komuna e Gjakovës, dhe K.N., nga fshati, Komuna e Gjakovës, për shkak të veprave penale, blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge, nga neni 267 par. 2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, duke vendosur sipas ankesave të mbrojtësve së të akuzuarve A.F., av. Ndrec Dodaj, dhe K.N., av. Prenk Pepaj, të ushtruara kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.184/2021, të dt.24.10.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më 27.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

Me rastin e ankesave të mbrojtësve së të akuzuarve A.F., av. Ndrec Dodaj, dhe K.N., av. Prenk Pepaj, e sipas detyrës zyrtare anulohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.184/2021, të dt.24.10.2023, ashtu që çështja penale i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim e vendosje.

Pasi që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, është anuluar sipas detyrës zyrtare, ankesat e mbrojtësve së të akuzuarve A.F., av. Ndrec Dodaj, dhe K.N., av. Prenk Pepaj, tani për tani janë jolëndore.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjakovë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.184/2021, të dt.24.10.2023, janë shpallur fajtor të akuzuarit, A.F. dhe K.N. për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge, nga neni 267 par. 2 lidhur me neni 31 të KPK, dhe:

- të akuzuarit A.F., i ka shqiptuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej dy (2) viteve, dhe dënimin me gjobë në shumë prej 1500 (njëmijë e pesëqind) euro, të cilat dënime do të ekzekutohen menjëherë pasi që ky aktgjykim te merr formën e prerë,

- të akuzuarit K.N., i ka shqiptuar dënimin me dënim me burgim në kohëzgjatje prej dy (2) viteve e gjashtë (6) muaj, dhe dënimin me gjobë në shumë prej 1.500 (njëmijë e pesëqind) euro, të cilat dënime do të ekzekutohen menjëherë pasi që ky aktgjykim te merr formën e prerë.

Nëse të akuzuarit e lartcekur (apo ndonjëri nga të dënuarit) nuk dëshirojnë ose nuk mund të paguajnë dënimin me gjobe në shumë prej nga 1500 (njëmijë e pesëqind) euro, gjykata do të zëvendësoj dënimin me gjobë, në dënim me burgim në kohëzgjatje prej nga 75 (shtatëdhjetë e pesë) ditëve duke llogaritur një ditë burgimi të barabartë me 20 Euro të gjobës.

Është konfiskuar substanca narkotike e llojit kanabis-marihuana me peshë prej 3170.43 gr e sekuestruar dhe e përshkruar sikurse në vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve me nr. 2022-YËP-004 i datës 02.10.2022.

Urdhërohet Policia e Kosovës – stacioni policor në Gjakovë që pasi ky aktgjykim te merr formën e prerë të bëjë shkatërrimin e substancës narkotike të llojit kanabis-marihuana me peshë prej 3170.43 gr e sekuestruar dhe e përshkruar sikurse në vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve me nr. 2022-YËP-004 i datës 02.10.2022.

Koha e kaluar ne paraburgim nga dt.02.10.2022 e gjer me dt. 28.04.2023 secilit të akuzuar i është llogaritur në dënimin e shqiptuar me burgim sipas këtij aktgjykimi.

Obligohet secili i akuzuar, veç e veç që ti paguaj shpenzimet e procedurës penale sa do që të jenë ato sipas llogarisë së bërë në arkë të gjykatës, paushallin gjyqësorë në shumën prej nga pesëdhjetë (50) euro, si dhe në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej nga pesëdhjetë (50) euro, të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë kanë ushtruar:

- mbrojtësi i të akuzuarit A.F., av. Ndrec Dodaj, për shkak të vendimit për dënimin, duke propozuar që ankesa të aprovohet si e bazuar, dhe aktgjykim i gjykatës së shkallës së parë të anulohet kurse çështja penale të kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe vendosje, apo që i njëjti të ndryshohet dhe të akuzuarit ti shqiptohet dënim më i butë, me të cilin do të arrihet efekti dhe qëllimi i dënimit, dhe

- mbrojtësi i të akuzuarit K.N., av. Prenk Pepaj, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljeve të ligjit penal si dhe vendimit për dënimin, duke propozuar që ankesa e ushtruar të aprovohet si e bazuar, aktgjykim i shkallës së parë të ndryshohet, kurse i akuzuari K.N. të lirohet

nga akuza në mungesë të provave, apo që i njëjti të anulohet dhe çështja penale ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe vendosje.

Prokuroria e Apelit, me shkresën PPA/I.nr.626/2023, të dt.07.12.2023, duke u sqaruar përkitazi me ankesat e ushtruara, nga ana e mbrojtësve së të akuzuarve A.F., av.Ndrec Dodaj dhe K.N., av.Prenk Pepaj, të ushtruara kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.184/21, të dt.24.10.2023, aktgjykimit të ankimuar, si shkresave të tjera të lëndës, ka propozuar që ankesat e ushtruara, të refuzohen si të pabazuar, kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.184/21, të dt.24.10.2023, të vërtetohet.

Në kuptim të nenit 390 të KPPK, kolegji i kësaj gjykate ka caktuar seancën e kolegjit për dt.27.05.2024, dhe në mënyrë të rregullt i ka njoftuar të gjitha palët nga shkresat e lëndës.

Në seancë të kolegjit nuk kanë prezantuar asnjëra nga palët e njoftuara, edhe pse ka prova nga shkresat e lëndës për njoftimin me rregull.

Kolegji i kësaj gjykatë në kuptim të nenit 394 të KPPK, ka vlerësuar ankesat e ushtruara, aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, si dhe shkresat e tjera të lëndës, dhe ka ardhur në përfundim se:

Aktgjykimi i ankimuar përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, si dhe shkelje të tjera të cilat kushtëzojnë anulimin e tij.

Përkitazi me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, kolegji i kësaj gjykate e ka vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, ka konstatuar se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, përfshihet me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, të cilat rezultojnë nga dispozitivi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë.

Të akuzuarit A.F. e K.N., janë shpallur fajtor për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e pa autorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge, nga neni 267 par.2 lidhur me nenin 31 të KPK, mirëpo në veprimet e të akuzuarit të parë dhe të akuzuarit të dytë, rezulton se nuk janë specifikuar cilat janë veprimet inkriminuese të akuzuarit të parë A.F., të cilat veprime inkriminuese të akuzuarit të dytës, K.N., për të vërtetuar identitetin objektiv dhe subjektiv të veprës penale, për të cilën të njëjtit janë akuzuar dhe shpallur fajtor. Nga aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, përkatësisht dispozitivi i të njëjtit nuk mund të vihet në përfundim se çfarë ditën kritike ka kryer i akuzuari A., e çfarë i akuzuari K.N., përkundër asaj që në kualifikimin juridik rezulton se të njëjtit këtë vepër penale e kanë kryer si bashkë kryes.

Nga dispozitat ligjore, të cilat janë në fuqi, përkatësisht në nenin 7 të KPK, thuhet: “vepra penale është veprim i kundërligjshëm i caktuar me ligj, si vepër penale, tiparet e se cilës janë të përcaktuara me ligj, dhe për veprën penale që shpallet fajtor mund të shqiptohet sanksioni penal, ose masa e trajtimit të detyrueshëm”, kurse në rastin konkret në përshkrim të dispozitivit të

aktgjykimit, pasi që rezulton se e njëjta është kryer në bashkëkryerje, atëherë në nenin 31 të KPK, theksohet: “nëse dy apo më shumë persona së bashku kryejnë veprën penale, duke marrë pjesë në kryerjen e së njëjtës, ose thellësisht duke kontribuar kryerjes së saj, në një mënyrë tjetër, secili prej tyre është përgjegjës dhe dënohet me dënimin e paraparë për veprën penale”, nënkupton se në këtë çështje penale gjykata e shkallës së parë, pasi që nuk i ka vërtetuar veprimet inkriminuese të akuzuarit të parë, e as të akuzuarit të dytë në kryerjen e veprës penale, si dhe nuk e ka qartësuar institutin e bashkëkryerjes, së veprës penale, atëherë e ka lënë të pa kuptueshëm dispozitivin, të pa qartë dhe të pa kuartë dhe i njëjti si i tillë, krijon konfuzion në veprimin inkriminues të secilit të akuzuar.

Duke i vlerësuar mangësitë nga dispozitivi i aktgjykimit, kolegji ka ardhur në përfundim që gjykata e shkallës së parë pas pranimit të këtij aktvendimit, duhet të ri caktoj seancën gjyqësore, ti thërras të gjitha palët nga shkresat e lëndës, që gjatë punës të qartësoj veprimin inkriminues të akuzuarit të parë dhe të akuzuarit të dytë, për të vërtetuar institutin e bashkëkryerjes, e atëherë pasi që të konkretizoj secilin veprim inkriminues të secilit të akuzuar, të vendos çështjen penale për të proceduar më tutje.

Pasi që kjo çështje penale është vendosur që të anulohet, kolegji vlerëson se në këtë fazë të ndodhjes së procedurës, ankesat e mbrojtësve së të akuzuarve A.F., av.Ndrec Dodaj dhe K.N., av.Prenk Pepaj, tani për tani janë jo lëndore.

Nga arsyet e cekura më lartë, është vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi, në kuptim të nenit 402 të KPPK.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.689/2023, të datës 27.05.2024

Bashkëpunëtor profesional,
Endrit Ajeti

Anëtarët e kolegjit,
Hashim Çollaku

Kryetari i kolegjit,
Xhevdet Abazi

Kadrije Goga Lubishtani